



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DEKLARATË PËR SHTYP

*Tiranë, 7 tetor 2025*

Sot, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) prezantoi Raportin Vjetor të veprimtarisë për vitin 2024 në mbledhjen e përbashkët të Komisionit për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjatë prezantimit, Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, i shoqëruar nga z. Maksim Shuli, Anëtar i Bordit si dhe z. Elton B. Radheshi, Sekretar i Përgjithshëm, paraqitën para anëtarëve të Komisioneve Parlamentare një panoramë të plotë të punës së institucionit, e cila ka përfshirë ndër të tjera:

- ✓ Zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri, si dhe të veprimtarisë institucionale në mbështetje të tregut, konsumatorit dhe integritetit rajonal.
- ✓ Aktivitetin e kryer për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorëve të energjisë elektrike dhe gazit, duke garantuar sigurimin e furnizimit me energji elektrike, transparencën e tregut dhe zbatimin e politikave të qëndrueshme në diversifikimin e burimeve gjeneruese.
- ✓ Analizën e kryer për vlerësimin e ecurisë së prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, zhvillimet elektrike si dhe zhvillimeve në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) apo dhe monitorimin e çmimeve, tarifave dhe kushteve të licensimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në fushën e gazit natyror vlejné për tu theksuar zhvillimet e ALBGAS sha, projektet pilote për furnizimin me gaz natyror të rajonit të Korçës si dhe ecuria e TAP si projekt strategjik për diversifikimin e furnizimit. Një pjesë e rëndësishme në raportim i është kushtuar politikave nxitëse për energjinë e rinovueshme dhe vetëprodhimit, ku prodhimi nga energjia e pastër mbetet prioritet. ERE ka forcuar gjithashtu mekanizmat për mbrojtjen e konsumatorit, trajtimin e ankesave dhe rritjen e transparencës publike.

Raportimi i Kryetarit të ERE u përmyll me vlerësimin e pajtueshmërisë rregullatore, zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, sfidat për pjesën e mbetur të vitit 2025 dhe objektivat strategjikë për periudhën 2024 – 2026, duke reflektuar angazhimin e institucionit për një treg energjie konkurrues, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet evropiane.

Në këtë kuadër, z. Ahmeti nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional me Kuvendin, Qeverinë dhe aktorët e tregut, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe dinamik të sektorit energjetik në vend.

Kryetari dhe përfaqësuesit e ERE, iu përgjigjen pyetjeve të anëtareve të Komisioneve Parlamentare duke vlerësuar jo vetëm pyetjet dhe kërkesat e bëra prej tyre, për të kuptuar e njohur më mirë ecurinë e sektorit, por edhe detyrat e lëna për përmirësimin e veprimtarisë së ERE sa i përket mbikëqyrjes dhe rregullimit të këtij sektori tejet të rëndësishëm.